

Ekskluzive

Ekskluzive | Plumba në mes të ahengut familjar në Prizren – Policia sekuestron dy armë, 28 gëzhoja dhe arreston dy persona



Sinjali.com

01 Gusht 2026 12:30



Një aheng familjar në fshatin Korishe të Prizrenit përfundoi me ndërhyrjen e Policisë, pasi të shtënat me armë zjarri çuan në arrestimin e dy personave dhe sekuestrimin e armëve e municionit.

Sinjali mëson se të arrestuar janë **Agron Beqiri rreth 39-vjeçar** dhe **Arben Nrecaj rreth 40-vjeçar**.

Sipas burimeve, pas raportimit për të shtëna me armë, në vendin e ngjarjes kanë dalë hetuesit e Stacionit Policor Prizren-Veri, krimteknikët dhe njësitë mbështetëse, të cilët kanë kryer ekzaminimin e vendit të ngjarjes.

Gjatë këqyrjes së terrenit, në rrugën pranë shtëpisë ku po mbahej ahengu familjar janë gjetur dhe sekuestruar 28 gëzhoja, të cilat dyshohet se ishin shkrepur gjatë festës.

Hetimet kanë çuar në identifikimin e dy të dyshuarve, te të cilët Policia ka sekuestruar:

- një pistoletë me gaz, pa numër serik dhe pa mbishkrim, me një karikator;
- një pistoletë Glock 17 Gen 5, kalibër 9×19 mm, me një karikator të mbushur me 7 fishekë.

Gjatë intervistimit në prani të avokatëve mbrojtës, Agron Beqiri dhe Arben Nrecaj kanë pranuar se armët ishin në posedim të tyre dhe kanë deklaruar se kishin shkrepur disa herë në ajër gjatë ahengut.

Me urdhër të Prokurorit të Shtetit, ndaj tyre është iniciuar procedurë penale për veprat “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” dhe “Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm”, ndërsa të dy janë ndaluar për 48 orë.

Rasti mbetet nën hetim.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitnes
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera